

RESUME

Z. Koço Sokoli, Kryeauditues në Departamentin Juridik, Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Z. Sokoli ka lindur në 12 Maj 1967 në Durrës, pas përfundimit të shkollës së mesme ka vazhduar studimet e larta për Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, të cilat i finalizoi në vitin 1990.

Karriera e tij profesionale ka filluar që në vitin 1995, duke mbajtur postin e Shefit të Departamentit Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Ndërtimit, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në vitin 1997.

Prej vitit 1997 deri në vitin 2000, është angazhuar si inspektor në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Investimeve të Huaja, në Drejtorinë e Prokurimeve si dhe në Drejtorinë e Kontrollit të Institucioneve dhe Sh.a-ve.

Në vitin 2000 deri në vitin 2005, është transferuar në Ministrinë e Financave, përkatësisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në pozicionin e audituesit.

Nga viti 2005 e në vijim, Z. Sokoli është i punësuar në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku ka qënë pjesë e disa departamenteve, më konkretisht mund të përmëndim Departamentin e Kontrollit të Administratës së Lartë Publike; Drejtorinë Juridike, Metodologjisë dhe Kontrollit të Cilësisë; në Departamentin e Performancës si dhe aktualisht është pjesë e Departamentit Juridik në pozicionin e Kryeaudituesit.

Gjithashtu, gjatë periudhës së këtyre angazhimeve profesionale ka kryer në sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vëndit, të vlerësuara me çetifikatë, ku ndër to mund të përmëndim:

- *“Drejtëm, Organizim dhe Motivim”* nga Instituti i Menaxhimit dhe Administrimit Publik;
- *“Trajnim për Sistemin Fiskal”* nga NIK në Poloni;
- *“Trajning of Internal Auditors in Audit on Administrativ Procedurs”* nga Banka Botërore në Poloni;
- *“Auditim i Brendshëm”* nga Banka Botërore në Poloni;
- *“Hartim Legjislacioni”* nga Departamenti i Administratës Publike;
- *“Audit i Brendshëm në Sektorin Publik”* nga Ministria e Financës;
- *Kurs IT “IDEA 2004”* nga OSBE;
- *“Avokat”* nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- *“Prokurimi me mjete elektronike”* nga Agjencia e Prokurimit Publik.